



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja a, dhe nenit 34.1, shkronja d, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 28.12.2022, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Shukrije Bajgorës, Muhamed Sadikut, Adnan Sadikut, NPSH "Conin" dhe "Vëllezërit Asllani" SHPK.
- II. Pronat e paluajtshme që merren nga ky këmbim, kanë këto karakteristika:
 1. Parcela kadastrale nr. 07556-7, sip. 77 m², Certifikata e pronësisë nr. P- 71914059-07556-7, Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi të Shukrije Bajgorës, Muhamed Sadikut dhe Adnan Sadikut, pjesa e parcelës kadastrale 00752-0, sip. 337 m², Certifikata e pronësisë, nr. P- 71914050-00752-0, Zona kadastrale Matiçan, në pronësi NPSH "Conin" dhe parcela kadastrale 00823-50, sip. 180 m², Certifikata e pronësisë nr. P- 71914050-00823-50, Zona kadastrale Matiçan, në pronësi të "Vëllezërit Asllani" SHPK, me destinim rrugë.
 2. Ndërsa pronat e paluajtshme që do të jepen në këtë këmbim janë: pjesa e parcelës kadastrale, nr. 07773-1, sip. 215 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-07773-1, Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi, pasuri shoqërore "Ujërat", Prishtinë dhe pjesa e parcelës kadastrale nr. 07779-2, sip. 253 m², Certifikata e pronësisë nr. P- 71914059-07779-2, Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi, pasuri shoqërore "Ujërat" Prishtinë, me destinim ndërtim, sipas Planit rregullues "Kalabria", i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01, nr.35-18196, dt. 03.08.2005.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues "Kalabria", miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 35-17196, dt. 03.08.2005 dhe Planit zhvillimor Urban, i miratuar me Vendimin, nr. 01 nr.035-181427 dt.24.09.2013.
- IV. Pas shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.

- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarëve të parcelave kadastrale që do të këmbehen.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
- skica grafike,
 - kopjet e planit dhe
 - certifikatat e njësisë kadastrale.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës në gjuhët zyrtare.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-463/06-277190/22, më 29.12.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Arsyetim

Drejtoria e Urbanizmit në bazë të Vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore, 05, nr. 350/02-5176321, dt. 28.10.2021 dhe Vendimit për miratimin e plotësimimit dhe ndryshimit të Vendimit të kushteve ndërtimore, 05, nr. 351/02-33286/22/02, dt.15.06.2022 ka dhënë pëlqimin për këmbimin e parcelës kadastrale, nr. P-71914059-07556-7, sip. 77m² në pronësi të Shukrije Bajgorës, Muhamed Sadikut, Adnan Sadikut, Zona kadastrale, Prishtinë, pjesa e parcelës kadastrale nr. P-71914050-00752-0, sip. 337m², në pronësi të NPSH “Conin”, parcela kadastrale nr. P-71914050-00823-50, sip.180m², në pronësi të “Vëllezërit Asllani” SHPK, Zona kadastrale, Matiçan, me destinim rrugë, kurse pronat e paluajtshme komunale që do të jepen në këmbim janë: pjesa e parcelës kadastrale nr. P-71914059-07773-1, sip.215m², në pronësi: pasuri shoqërore “Ujërat”, Prishtinë, pjesa e parcelës kadastrale nr.P-71914059-07779-2, sip.253m², në pronësi: pasuri shoqërore “Ujërat” Prishtinë, Zona kadastrale Prishtinë me destinim ndërtim.

Propozimi për iniciimin e këmbimit të parcelës së tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit sipas Planit rregullues “Kalabria”, miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 35-17196, dt. 03.08.2005 dhe Planit zhvillimor urban, i miratuar me Vendimin nr. 01 nr.035-181427, dt.24.09.2013, parcela kadastrale, nr. 7556-7, Zona kadastrale Prishtinë, pjesa e parcelës kadastrale, nr.752-0, pjesa e parcelës kadastrale, nr.823-50, Zona kadastrale Matiçan, shtrihen në zonë të planifikuar për rrugë, ndërsa pjesa e parcelës kadastrale nr. 7773-1 dhe pjesa e parcelës kadastrale nr. 7779-2, Zona kadastrale Prishtinë, shtrihen në zonën e planifikuar për ndërtim.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019).

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij Vendimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private, siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.